

S2ASPORTMOBILITY

Përmirësimi i Aftësive të Administratorëve Sportivë përmes të Mësuarit në Lëvizje (Learning Mobility)



www.eose.org



KONTEKSTI DHE ARSYETIMI

Ka një vlerësim në rritje të potencialit social dhe ekonomik të sportit, e si rezultat, një nivel në rritje të pritshmërisë nga qeveritë kombëtare për sektorin që të bëhet një mjet i fuqishëm i lidhur me politikën kryesore në arsim, shëndetësi dhe ekonomi, e kështu të përdoret për të promovuar kohezionin social.

Për të arritur këto pritshmëri, është e domosdoshme që ata që punojnë ose janë vullnetarë në sport të jenë të pajisur me aftësi dhe njohuri të nevojshme për të realizuar detyrat në pozicionet e tyre.

Sidoqoftë, sektori është kompleks, i fragmentuar dhe në zhvillim. Biznese dhe vende të reja pune po krijohen, ndërsa aftësi të reja nevojiten si për profesionistët ashtu edhe për armatën e madhe të vullnetarëve që janë në zemër të sektorit për të përputhur pritshmëritë nga qeveritë dhe tregut të punës.

Ambicia e projektit 24-mujortë S2A të Sport në Lëvizje, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, është të mbështesë sektorin duke zhvilluar potencialin e tij nëpërmjet përmirësimit të aftësive të administratorëve sportivë, si dhe të rrisë mundësitë e punësimit të tyre në të ardhmen, sikurse zhvillimin personal përmes përvojave të mësuarit në lëvizje.

Funksionet e administrimit sportiv zbatohen nga të gjithë ata individë, si staf me pagesë ashtu edhe vullnetarë, të cilët punojnë për të siguruar drejtimin efektiv të një organizate sportive në përputhje me qëllimin dhe drejtimin e saj.





OBJEKTIVAT KRYESORE

Qëllimi i programit S2A Sport Mobility është të ofrojë mundësinë për 40 pjesëmarrës nga Bashkimi Evropian dhe 4 vende të caktuara nga Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Republika e Maqedonisë së Veriut) për të marrë pjesë në një program të përshtatshëm trajnimi ndërshtetëror mbi administrimin sportiv që do të ofrohet përmes 3 moduleve me kohëzgjatje 1 javë në 3 vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor.

Programi i trajnimit do të plotësohet nga një vizitë studimore kombëtare 4 ditore për secilin pjesëmarrës, që të marrë një përvojë zhvillimore jashtë vendit në sektorin e sportit.

Ndikimi i pritshëm është rritja dhe përmirësimi i aftësive të pjesëmarrësve, forcimi i aftësisë së tyre për punësim në të ardhmen dhe zhvillimi personal, zgjerimi i rrjetit të tyre, kontributi në ngritjen e kapaciteteve të organizatave të tyre dhe zhvillimin e sportit në BE dhe Ballkanin Perëndimor.

RRITJA E AFTESIVE TE ADMINISTRATOREVE SPORTIVE PERMES TE MESUARIT NE LEVIZJE





PJESËMARRËSIT

Të 40 pjesëmarrësit do të duhet të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në menaxhimin/administrimin e një organizate sportive të tilla si federata sportive, klub sportiv, autoritet lokal, Komitet Olimpik Kombëtar, organizatë e sport për të gjithë, etj

32 pjesëmarrës gjithsej do të vijnë nga Ballkani Perëndimor (8 nga secili vend i synuar) dhe 8 nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, dhe secili vend partner do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen duke siguruar një diversitet të mirë të pjesëmarrësve.



NDIKIMET E PRITSHME

- 🌍 Promovim dhe bërje e mësuarit në lëvizje një realitet në sektorin e sportit;
- 🌍 Demonstrim i përfitimeve kryesore të përvojave të tilla jashtë vendit për individët, organizatat dhe sektorin e sportit në tërësi;
- 🌍 Inkurajim i bashkëpunimit ndërkombëtar;
- 🌍 Kapacitet i qëndrueshëm dhe i përmirësuar i organizatave sportive me burime njerëzore të pajisur mirë me aftësi;
- 🌍 Sporti të arrijë potencialin e tij dhe të ndikojë në ndryshimet shoqërore.



NJË NISËM TRANSNACIONALE

Koordinuar nga Observatori Evropian i Sportit dhe Punësimit (EOSE), projekti S2A Sport Mobility është i përbërë nga një konsorcium me 8 partnerë, përfshirë 3 Komitete Olimpikë Kombëtare, 3 universitete dhe 2 rrjete sportive Evropiane.

Gjysma e partnerëve vijnë nga Ballkani Perëndimor dhe gjysma tjetër nga Bashkimi Evropian.

PARTNERITETI ZYRTAR I

PROJEKTIT S2A SPORT MOBILITY



European Observatoire of Sport and Employment (EOSE)

Koordinatorin e Projektit

Evropë / Francë



University of Chester

Mbretëri e Bashkuar



Université Catholique de Louvain (UCL)

Belgjikë



European Association for Sport Management (EASM)

Evropë / Gjermani



Albanian National Olympic Committee

Shqipëri

KOSOVO



National Olympic Committee of Kosovo

Kosovë



National Olympic Committee of North Macedonia

Republika e Maqedonis së Veriut



University of Montenegro / Faculty of Sport and PE

Mali i Zi



KONTAKT

Nëse dëshironi të merrni informacione të mëtejshme rreth projektit S2A Sport Mobility, të përfshiheni në fazat e konsultimit të projektit, ose të merrni pjesë në ofrimin e trajnimit, ju lutemi kontaktoni EOSE, Koordinatorin e Projektit, në:

S2A-Sport-Mobility@eose.org

www.eose.org



Co-funded by
the European Union

Mbështetja e Komisionit Evropian për prodhimin e kësaj broshure nuk përbën një miratim të përmbytjes, e cila pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve, dhe Komisioni nuk mund të jetë përgjegjës për çdo përdorim që mund të bëhet nga informacionet e përfshira në të.